



Art-Auditing

, për të ndërtuar besimin!

Rruga Artan Lenja,
Kompleksi Magnet, Tiranë
Email: merilika@outlook.com
Tel: 069 20 24 448

Nr. 13 prot

Tiranë më 23 shtator 2021

Lënda: Informacion për auditimet e partive

Drejtuar: Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve

Në bazë të vendimit nr. 425 datë 12.07.2021 KQZ më ka emëruar për të audituar partitë si vijon:

- 1- Partia Kristian Demokrate
- 2- Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut
- 3- Partia Shpresa Demokrate
- 4- Partia Demokratike Peza Gjirokastrë e Shqipërisë
- 5- Lista për Shqipëri Natyrale
- 6- Partia Socialiste e Vërtetë 91
- 7- Partia Bindja Demokratike
- 8- Partia e re Socialiste e Shqipërisë


Nga kjo listë unë kam dorëzuar raportin e auditimit për Partinë Bashkimi për të drejtat e Njeriut.

Në lidhje me partië e tjera informoj si vijon:

- 1- Partia Kristian Demokrate – ka dorëzuar pasqyra financiare në KQZ por e kam pasur të pamundur të kryej misionin duke qenë se financieri i saj z. Nik Neçaj ndodhet në shtëpi i izoluar nga Covid 19. (njoftuar KQZ me email e datës 21/09/2021 (bashkengjitur foto sms e z. Nik Neçaj)



- 2- Partia Shpresa Demokrate – nuk ka dorëzuar pasqyra financiare pranë KQZ-së. Letra e nisur me postë nuk më është kthyer pas. Jam përpjekur të kontaktoj fillimisht me e-mail në datën 02/09/2021 në email-in që gjendet në faqen e tyre zyrtare¹. Pasi nuk mora përgjigje, në datën 15/09/2021 i jam drejtuar nëpërmjet rrjetit social Facebook si dhe nëpërmjet platformës ehatsapp në numrin +19736527578. Mesazhet lexoheshin por nuk merrja asnjë përgjigje. Pasi e ripërsërita sërish kërkesën në platformën ehatsapp më në fund në datën 22.09.2021 në rrjetin social ehatsapp mora përgjigjen si vijon:




Gjithashtu në lidhje me këtë parti kam përdorur edhe informacionin që gjendet në faqen (arkivë) të KQZ-së ku kjo parti në adresën që ka KQZ nuk është gjetur nga audituesi i vitit 2018²

- 3- Partia Demokratike Peza Gjirokastrë e Shqipërisë – nuk ka dorëzuar pasqyra financiare pranë KQZ-së. Të dhënat e saj të ofruara nga KQZ janë vetëm Tiranë. Pasi kryeva procedurën postare të njoftimit jam telefonuar nga punonjësja e postës e cila më konfirmoi se letra është nisur fillimisht në Pezë, nga aty është kthyer pas dhe është rinisur në Gjirokastrë sepse punonjësit e postës e mendonin se emri Peza Gjirokastrë ishte adresë dhe jo emri i partisë. Sapo të marr kthimin pas të letrës do ta depozitoj pranë KQZ-së. Pra me këtë parti nuk kam mundur të kontaktoj. Gjithashtu në lidhje me këtë parti kam përdorur edhe informacionin që gjendet në faqen

¹ <https://www.partishpresademokrate.com/profile/d7c1b5fb-1f8d-4f9b-a74b-84565d11a0b3/profile>

² <http://cec.org.al/wp-content/uploads/2019/07/Partia-Shpresa-Demokratike-04072019133411.pdf>





(arkivë) të KQZ-së ku kjo parti në adresën që ka KQZ nuk është gjetur nga audituesi i vitit 2018.³

- 4- Lista për Shqipëri Natyrale – nuk ka dorëzuar pasqyra financiare pranë KQZ-së. Përveç ërkesës së nisur me postë nga e cila nuk kam asnjë përgjigje, i jap drejtuar kryetarit të kësaj partië në email: kdanaj@hotmail.com të cilën e gjeta në rrjetin social Facebook tek profili i zotit Danaj⁴. Por nuk kam marrë asnjë përgjigje.
Gjithashtu në lidhje me këtë parti kam përdorur edhe informacionin që gjendet në faqen (arkivë) të KQZ-së ku kjo parti në adresën që ka KQZ nuk është gjetur nga audituesi i vitit 2018⁵
- 5- Partia Socialiste e Vërtetë 91 – nuk ka dorëzuar pasqyra financiare. Me këtë parti pas shumë përpjekjesh arrita të komunikoj nëpërmjet rrjetit social Facebook. Kryetari i kësaj partie pas dy mesazheve të mia në datën 02.09.2021 dhe më pas në 05.09.2021 më është përgjigjur në datën 14.09.2021 duke më dërguar numrin e tij të telefonit. Pasi komunikova në telefon z. Koçi më njoftoi se partia nuk funksiononte më dhe se ishin duke kryer procedurat e çregjistrimit nëpërmjet avokatit të tyre. Gjithsesi ai me një sms më dha numrin e telefonit të financieres znj. Teuta Peçollari, e cila si dhe iu kam informuar në e-mailin e datës 21.09.2021 e dinte të çregjistruar partinë dhe se nuk kishte dijeni për formatin e pasqyrave financiare. I dërgova nëpërmjet e-mail teuta.pecollari@gmail.com, formatin e pasqyrave financiare por nuk mora më asnjë përgjigje.
- 6- Partia Bindja Demokratike – nuk ka dorëzuar pasqyra financiare pranë KQZ-së. Në datën 02.09.2021 në e-mail e partisë të cilin e gjeta në faqen zyrtarë të saj⁶, e njoftova partinë për përzgjedhjen time si audituese e pasqyrave financiare por, nuk mora asnjë përgjigje. Në datën 14.09.2021 duke qenë se nuk mora asnjë përgjigje nga e-maili zyrtar, iu drejtova kryetarit të partisë nëpërmjet rrjetit social Facebook. Në datën 15.09.2021 më telefonon përfaqësuesi i kësaj partie z. Fabjan Topollaj të cilin e sqarova për misionin por zotëria këmbëngulte se nuk dorëzonte pasqyra financiare sepse ishte në gjyq me KQZ-në. Pasi komunikova disa ditë më në fund në datën 20.09.2021 u takuam në ambientet e partisë Bindja Demokratike ku u informova se kjo parti nuk kishte dorëzuar pasqyra financiare sepse KQZ ende nuk i kishte njoftuar formatin e pasqyrave. E sqarova zotërinë se formati i pasqyrave financiare vjetore nuk përcaktohet nga KQZ por është i përcaktuar nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit si dhe nga ligji për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. Në vazhdim të komunikimit nëpërmjet platformës ehatsapp i

³ <http://cec.org.al/wp-content/uploads/2019/07/Partia-Demokratike-Peza-Gjirokaster-e-Shqiperise-04072019133046.pdf>

⁴ <https://www.facebook.com/KocoDanaj>

⁵ <http://cec.org.al/wp-content/uploads/2019/06/Partia-Lista-per-Shqiperine-Natyrale-27062019133427.pdf>

⁶ <https://bd.al/kontakt/>



Art-Auditing , për të ndërtuar besimin!

Rruga Artan Lenja,
Kompleksi Magnet, Tiranë
Email: merilika@outlook.com
Tel: 069 20 24 448

kam dërguar formatin e pasqyrave financiare si dhe mbështetjen ligjore për to, si dhe ju kam informuar në e-mail e datës 21.09.2021, dhe nga ana e subjektit mu tha se do të përgatiteshin pasqyrat financiare, por deri më sot ende nuk më është dorëzuar asgjë.

- 7- Partia e re socialiste e Shqipërisë – nuk ka dorëzuar pasqyra financiare. Komunikimi me këtë parti nuk ka qenë i mundur sepse edhe në të dhënat e vendosur në dispozicion nga KQZ, adresa e saj është vetëm Tiranë. Letra e nisur me postë në adresën e saj në vend që të kthehej mbrapsh ka shkuar në zyrat e subjektit Partia Socialiste. Sot datë 23.09.2021 telefonohem nga numri 0693844647 dhe më prezantohet zonja Dhurata Isufaj, financiere e Partisë Socialiste dhe më njofton se ka disa ditë që ka marrë në dorë njoftimin tim por kësaj partie i kishte shkuar audituesi dhe znj. Isufaj nuk e kuptonte se përse duhet të isha edhe unë. E sqarova se letra kishte shkuar gabim atje sepse në fakt është për Partinë e Re Socialiste. Pasi e verifikoi edhe znj. Isufaj sqarimin tim më konfirmoi se do të ma kthej letrën sërish me postë në adresën time. Sapo ta kem këtë letër do ta përcjell pranë KQZ-së. Në arkivën e KQZ-së për raportet e auditimit të vitit 2018 kjo parti nuk ka asnjë të dhënë.⁷

Bashkëngjitur kësaj letre informuese janë dhë të gjitha komunikimet që kam kryer me partinë si kam shpjeguar dhe më sipër.

Me respekt

Auditues Ligjor

Meri Lika

⁷ <http://cec.org.al/raportet-e-auditimit-per-fondet-vjetore-te-partive-politike/>